



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 10, datë 10.02.2026



**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NGA GRANTI I BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, aneksit 9 “Granti i Performancës për bashkitë”, udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1, datë 11.07.2025, “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”, si edhe në vijim të shkresës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, që ka përfituar bashkia Durrës është 5,024,923.98 lekë, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,024,923.98 (pesëmilion e njëzet e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë të përfituar nga Granti i Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025 për: “Blerjen e mjeteve didaktike për pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor (kopshteve) në territorin e Bashkisë Durrës.

2. Ky fond do të financohet në vlerën 2,247,191.01 (dymilion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e një qind e nëntëdhjetë e një pikë zero një) lekë nga buxheti i shtetit dhe në vlerën 2,777,732.97 (dymilion e shtatë qind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë është financim i huaj.
3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.02.2026






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 140/10 prot.

Durrës, më 16.02.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.10 datë 10.02.2026 ,” Për përdorimin e fondit të përfutur nga granti i bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

